



C.nr.103/2012

GJYKATA THEMELORE NË Ferizaj -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,gjyqtari Burim Emërllahu ,duke vendosur në qështjen kontestimore të ndërhyrësit kryesore [REDACTED] ,nga Fshati [REDACTED] ,Komuna e Ferizajit ,kundër të paditurve [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] ,Komuna e Ferizajit dhe [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] , tani me adresë të panjohur të vendbanimit të cilin e përfaqëson av.[REDACTED] nga Ferizaji ,baza juridike vërtetimi i pronësisë ,pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë me datë **12.07.2016** ,mori këtë:

AKT GJYKIM

I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadi e ndërhyrësit kryesorë [REDACTED] ,nga Fshati [REDACTED] ,Komuna e Ferizajit ,kundër të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe vërtetohet se ndërhyrësi kryesor [REDACTED] është pronarë i ngastrës kadastrale nr.910-0,me sipërfaqe prej 3694 m2,në vendin e quajtur "Topola" ,Zona kadastrale Lloshkobare ,Komuna Ferizajit .

II.Detyrohet ndërhyrësi kryesorë [REDACTED] ,që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore t'ia paguaj shumën e të hollave prej 50 euro.

Arsyetim

Pika I.R [REDACTED] ,nga Fshati [REDACTED] ,Komuna e Ferizajit ,ka parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurit [REDACTED] ,tani me vendbanim të panjohur ,me të cilën padi ka kërkuar nga gjykata që me aktgjykim të vërtetoj se [REDACTED] është pronarë i ngastrës kadastrale nr.910 ,me sipërfaqe prej 3694 m2,në vendin e quajtur "Topolla" ,Zona kadastrale Lloshkobare . [REDACTED] në padi ka theksuar se sipas kontratës me shkrim ,të datës 15.08.1985 ,ka blerë nga i padituri I [REDACTED] ,ngastrën kadastrale ,të sipër përmendur ,për qmimin e shitblerjes prej 1.295.000,00,me fjalë njëmiljon e dyqind e nëntëdhjetë e pesë dinarë,të athershëm ,të cilën e ka paguar në tërësi dhe ka hyr ne posedim të paluejtshmërisë në fjalë.Në seancën e datës 19.02.2016 [REDACTED] ka deklaruar se paluejtshmërinë e sipër përmendur pas blerjes ia kam falur vllaut tim [REDACTED] ,rreth vitit 1987 dhe jam pajtuar që kjo tokë të jetë në pronësinë e tij.

[REDACTED] ,nga Fshati [REDACTED] ,Komuna e Ferizajit ,ka hyrë në cilësin e ndërhyrësit kryesorë në procesin gjyqësorë që ishte në zhvillim e sipër ,ndërmjet [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe [REDACTED] me kërkespadi ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadi e ndërhyrësit kryesorë [REDACTED] ,nga

shkurtër pas blerjes së përmendur si në pikën III të arsyetimit të këtij aktgjykimi
[redacted] paluejtshmërin kontestuese i'a ka faluar vllaut të tij [redacted]



Nga deklarata e dëshmitarëve [redacted], [redacted], [redacted], si dhe deklarata e të paditurit [redacted] dhe ndërhyrësit kryesorë [redacted] në cilësi të palës ,gjykata ka vërtetuar se ndërhyrësi kryesorë [redacted] është në posedim të paluejtshmëris së sipër përmendur të cilën e ka shfrytëzuar më tepër se 20 vite.

Nga deklarata e dëshmitarit [redacted] gjykata ka vërtetuar se dëshmitari [redacted] [redacted] në paluejtshmërin kontestuese e ka parë [redacted] duke kositur ,duke ecur shpesh ,nga viti 2002.

Nga deklarata e dëshmitarit [redacted] gjykata ka vërtetuar se edhe nga viti 2003 [redacted] është kujdesur dhe e ka punuar paluejtshmërin kontestuese dhe askush nuk e ka penguar.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si në Piken III të arsyetimit të këtij aktgjykimi ,ka vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,duke u bazuar edhe në dhe dispoziten e neni 28 të Ligjit për Mardhënjet Themelore Pronësore juridike,si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore ,kuptohet për periudhen kohore në të cilën është në fuqi ky ligj ,si dhe në faktin se kontrata e sipër përmendur e lidhur në mes të palëve kontraktuese ishte zbatuar në tërësi.

Vendimi për taksën për aktgjykimi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë :12.07.2016



Gjykatësi

Edrim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA



VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUDOISHËM
DOKUMENTI JE PRAVOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

08-20-16